

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 45, deri më 10.11.2024)


Të dhëna javore

Gjatë javës së dyzetë e pestë të vitit 2024 (nga 04-10.11.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 67 raste ($I=3,7/100.000$ banorë) të të prekurve nga grip/sëmundjet e ngjashme me gripin, 42,6% më shumë se javën e kaluar (47). Krahasuar me javën e dyzetë e pestë të vitit të kaluar (47), është regjistruar një rritje prej 42,6%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (55) është regjistruar një rritje prej 4,2%.

Gjatë javës së 45 të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 15 materiale për analiza laboratorike për gripin, nga të cilat 6 nga mbikëqyrja SARI, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Incidenca e kativitetit sezonal të virusit të gripit ($I=26,1/100.000$) është nën pragun sezonal, (Grafiku 1).

Grafiku 1. Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025



Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në Kumanovë – 20, Gostivar-19, Tetovë – 17, Kavadar – 5, Strumicë – 3, Radovish-2 dhe Negotinë-1.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 42 persona, tek grupmosha mbi 65 vjet – 10 dhe tek fëmijët nga 0-4 -1 rast.

Të dhëna kumulative

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 262 raste ($I=14,3/100.000$).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar ($n=287$), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rënie prej 8,7%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit ($n=264$) është regjistruar një rënie prej 0,6%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 11 QSHP/NJR. Numri më i madh ($n=85$) është regjistruar në Kumanovë, ndërsa incidencë më e lartë kumulative ($92,1/100.000$) është regjistruar në territorin e Gostivarit.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) - 162 raste (61,8%), ndërsa incidencë më e lartë ($25,1/100.000$) tek fëmijët e moshës 5-14 vjet ($n=54$).

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Gjithsej deri më tani janë analizuar 84 materiale, e që të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e 45, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 99 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Deri më tani është regjistruar një rast me SARS-CoV-2. Nuk janë regjistruar raste pozitive me grip dhe RSV.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 60.909 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.423 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 62.332 persona me vakcina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN - ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary)

*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e 44 të sezonit të ri 2024/2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit është në nivel messezonal, që është karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 3 nga 31 vende të rajonit evropian të OBSH-së.

Numri i rasteve me SARS-COV-2 vazhdon të bjerë, por ka dallime mes vendeve. Grupmoshat më të mëdha vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të rasteve. Aktiviteti i gripit dhe RSV mbetet në nivel të ulët, por me një rritje të shkallëzuar.

Në nivel rajonal, pranimet në spital dhe në repartet e kujdesit intensiv si pasojë e gripit dhe RSV janë në nivele stabile. Pranimet si pasojë e SARS-COV-2 janë stabile.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik